



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
REKTORI

Nr. 4092/prot.

Shkodër, më 11.12.2018

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për katër vende të lira pune, si më poshtë vijon :

II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Matematikës, për dy pozicione Lektor/e me kohë të plotë i/e lëndëve "Teknologji informacioni dhe komunikimi", "Programim në Windows", "Bazë të dhënash", "Sisteme shfrytëzimi dhe rrjete", "Gjuhë formale" dhe "Inxhinjeri softesh".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret specifike :

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e shkollimit me kohë të plotë në specialitetin "Informatikë".
2. Të kenë kryer ciklin e parë të studimeve në sistemin me kohë të plotë, në degën "Informatikë" me notë mesatare mbi 8.5.
3. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë "Master i Shkencave" me drejtim Informatikë me notë mesatare mbi 8.5.
4. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë "Master i Shkencave" ose "DIND" (300 ECTS) në profilin "Informatikë", me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
5. Të kenë noten mesatare të lëndëve për të cilat konkurrojnë mbi 9.
6. Të kenë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja të BE-së me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1 (sipas Udhëzimit nr.11, datë 10.04.2017, me nr.3661 prot.)
7. Preferohet të kenë titull akademik apo gradë shkencore "Doktor", me aktivitet të pasur botues.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë veprimi, aftësi të punës në grup, aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
6. Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a unjë) apo **krushqie** (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkjetues i fëmijëve) me punonjës egzistues brenda të njëjtes njësi bazë apo ndihmëse ku kërkohen të punësohen.



